

VENDIM
Nr.550, datë 12.8.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.329, DATË 12.7.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E TENDERIT PËR ZGJEDHJEN E INVESTITORËVE
STRATEGJIKË DHE PËR TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TË ZOTËRUARA NGA
SHTETI NË SHOQËRITË TREGTARE TË SEKTORËVE ME RËNDËSI TË VEÇANTË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1 e kapitullit III të vendimit nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshohet dhe të riformulohet si më poshtë vijon:

“1. Një njoftim publik botohet në tri gazeta me qarkullim ndërkombëtar. Koha dhe mënyra e publikimit përcaktohen rast pas rasti nga komiteti i konsulencës dhe i transparencës për privatizimin e sektorëve me rëndësi të veçantë të ekonomisë, me asistencën e shoqërisë konsulente. Njoftimi afishohet në zonën pranë selisë së shoqërisë tregtare që do të privatizohet, si dhe dërgohet me anë të letrave, telefaksit dhe publikohet në internet.”.

2. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano